FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

CUTASON

Tableta – 5 mg

Lënda vepruese: Prednizon

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ja jepni personave të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore bëhet serioz ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Cutason dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Cutason
3. Si ta merrni Cutason
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Cutason
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË CUTASON DHE PËRSE PËRDORET

Cutason është një glukokortikoid (hormon i gjendrës mbiveshkore) që ndikon në metabolizëm, në bilancin e kripërave (elektrolitëve) dhe në funksionimin e indeve.

Cutason indikohet në sëmundjet që kërkojnë një terapi sistemike me glukokortikoidë.
Në varësi të mënyrës si paraqitet dhe gravitetit të sëmundjes, këtu përfshihen (Tabela me **dozime nga a në d dhe dozimi e**, shih pikën 3: Si ta merrni Cutason):

Si terapi zëvendësuese e hormoneve në:
- insufiçiencën ose dështimin e gjendrës mbiveshkore për shkaqe të ndryshme (si p.sh. sëmundja Addison, hiperplazia kongjenitale e gjendrës mbiveshkore, heqja kirurgjikale e gjendrës mbiveshkore, insufiçienca hipofizare), pasi ka kaluar mosha e rritjes (në këto raste kortizoni dhe hidrokortizoni janë zgjedhja e parë)
- gjendje stresi të shkaktuara nga përdorimi afatgjatë i kortikoidëve.

Çrregullime reumatike:
- gjatë fazave aktive të inflamacionit vaskular (Dozimi: a,b):
  - poliarterit nodoz (nëse pacienti vuan nga hepatiti B, koha e trajtimit duhet kufizuar në dy javë)
  - arterit me qeliza gigante, dhimbje dhe ngurtësi të muskujve (polimialgji reumatike) (Dozimi: c)
  - inflamacion i arteries temporale (arterit) (Dozimi: a), në humbjen akute të shikimit jepen fillimisht doza sulmi glukokortikoidësh endovenë e më pas vazhdohet trajtimi kronik duke mbajtur nën kontroll sedimentimin e eritrociteve
- gjatë fazave aktive të sëmundjeve reumatike që prekin organet e brendshme (Dozimi: a, b): lupus eritematoz që prek organet e brendshme, dobësi dhe dhimbje e muskujve (polimiozit), inflamacion i kartilagos (polychondritis chronica atrophicans), çrregullime të indit lidhor (MCTD)
  - artriti reumatoid me zhvillim të shpejtë dhe të rëndë (Dozimi: a deri në d) si p.sh. forma shkatërruese të rikthyeshme ose ato që prekin artikulacionet (Dozimi: b)
  - sëmundje të tjera reumatike që prekin artikulacionet, nëse sëmundja për nga graviteti kërkon këtë lloj trajtimi dhe nëse disa barna për trajtimin sëmundjeve reumatike (AIJS) nuk kanë dhënë efekt ose nuk mund të përdoren
  - inflamacion i shtyllës kurrizore (spondiloartrit), inflamacion i shtyllës kurrizore (spondilit ankilozant) që prek dhe artikulacione të tjera si ato të krahëve dhe këmbëve (Dozimi: b, c), psoriazë që prek artikulacionet (artrit psoriatik) (Dozimi: c, d), çrregullime gastrointestinale që shoqërohen me inflamacion të rëndë dhe prekin artikulacionet (artropati enteropatike) (Dozimi: a)
  - artrit që vjen si pasojë e një tjetër sëmundjeje ekzistuese (Dozimi: c)
  - inflamacion i artikulacioneve që vjen si pasojë e sarkoidozës (Dozimi: b në fillim të terapisë)
  - artrit i rëndë që shfaqet pa shkaqe të dukshme tek adoleshentët (artriti juvenil idiopatik) dhe që prek organet e brendshme (sëmundja Still) ose që prek syrin (inflamacion i irisit dhe zonave përreth) dhe nuk i përgjigjet trajtimit lokal (Dozimi: a)
  - inflamacion i zemrës në ethet reumatike, në rastet e rënda mbi 2-3 muaj (Dozimi: a).

Sëmundjet e bronkeve dhe të mushkërive:
- astmë (Dozimi: c-a), në të njëjtën kohë rekomandohet ndjekja e një trajtimi bronkodilatator
- përkeqësim akut të sëmundjeve ekzistuese kronike obstruktive të rrugëve të frymëmarrjes (Dozimi: b), kohëzgjatja e rekomanduar e trajtimit: deri në 10 ditë
- disa sëmundje specifike të mushkërive si: inflamacioni akut i alveolave (alveolit) (Dozimi: b), ngurtësim dhe rimodelim të indit të mushkërive (fibrozë pulmonare) (Dozimi: b), si trajtim mbajtës i formave kronike të sarkoidozës në fazat II dhe III (që shoqërohen me dispne, kollë dhe insufiçiencë të mushkërive) (Dozimi: b)
- si trajtim parandalues në sindromën e ankthit të frymëmarrjes tek foshnjat e lindura para kohe (Dozimi: b, i përsëritur dy herë)

Sëmundje të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes:
- forma të rënda të etheve nga bari dhe rinitit alergjik në rastet kur glukokortikoidët të dhënë si spraj në hundë nuk kanë dhënë efekt (Dozimi: c)
- ngushtime akute të laringut ose trakesë: angioedemë, laringit obstruktiv (peudo-krup) (Dozimi: b deri në a)

Sëmundje të lëkurës:
- sëmundje të lëkurës dhe membranave mukoze që për shkak të gravitetit dhe/ose përfshirjes së disa organeve nuk mund të trajtohen në mënyrë lokale me glukokortikoidë

Këtu përfshihen:
  - reaksione alergjike dhe reaksione të ngjashme me to, reaksione alergjike të shoqëruara me infeksione: si p.sh. urtikaria akute, shoku anafilaktik
  - sëmundje të rënda të lëkurës, që shkatërrojnë pjesërisht lëkurën, rash-i ndaj barnave, eritema multiforme, nekroliza epidermale toksike (sindroma Lyell), pustulosis acuta generalisata, eritema nodoze, dermatoza akute neutrofilike e shoqëruar me temperaturë (sindroma Sweet), dermatitialergjik nga kontakti (Dozimi: b deri në a)
  - rash-i: si p.sh. rash i shkaktuar nga një reaksion alergjik si dermatiti atopik ose dermatiti i kontaktit, rash i shkaktuar nga patogjenë (ekzema numulare) (Dozimi: b deri në a)
  - sëmundje që shoqërohen me shfaqjen e pullave në lëkurë: si p.sh. sarkoidoza, inflamacioni i buzëve (granulomatous cheilitis) (Dozimi: b deri në a)

- sëmundje të rënda që shoqërohen me shfaqjen e flluskave në lëkurë: si p.sh. pemfigus vulgaris, pemfigusi buloz, pemfigusi beninj i membranave mukoze, dermatoza IgA lineare (Dozimi: b deri në a)
- vaskuliti: si p.sh. vaskuliti alergjik, poliarteriti nodoz (Dozimi: b deri në a)
- çrregullime të sistemit imunitar (sëmundje autoimune si p.sh. dermatomioziti, sklerodermia sistemike (në fazën e ngurtësimit), lupusi eritematoz diskoid kronik dhe subakut kutan (Dozimi: b deri në a)
- sëmundje të lëkurës gjatë periudhës së shtatzënisë (shih gjithashtu pikat "shtatzënia" dhe "ushqimi me gji"): si p.sh. Herpes gestationitis, impetigo herpetiforme, (Dozimi: d deri në a)
- sëmundje të rënda të lëkurës që shoqërohen me eritemë, rrjepje, si p.sh. psoriaza pustulare, pityriasis rubra pilaris, grupi i parapsoriazave (Dozimi: c deri në a)
- eritroderma, edhe e shoqëruar me sindromën Sezary (Dozimi: c në a)
- sëmundje të tjera të rënda: si p.sh. reaksioni Jarisch-Herxheimer ndaj penicilinës gjatë trajtimit të sifilizit, hemangioma kavernoze me zhvillim të shpejtë, sëmundja Behçet, pioderma gangrenoze, fasciiti eozinofilik, likeni planus ekzantematik, epidermioliza buloze e trashëguar (Dozimi: c në a).

Sëmundje të gjakut / sëmundje neoplazike
- sëmundje autoimune të gjakut:
  anemia e shkaktuar nga shkatërrimi i rruazave të kuqe të gjakut nga vetë organizmi (anemia hemolitike autoimune) (Dozimi: c deri në a)
  purpura trombocitopenike idiopatike (sëmundja Werlhof) (Dozimi: a)
  fazat akute të rënies së numrit të pllakëzave të gjakut (trombocitopenia intermitente) (Dozimi: a)
- sëmundje malinje si p.sh.:
  leuçemia akute limfoblastike (Dozimi: e)
  sëmundja Hodgkin (Dozimi: e)
  limfoma jo-Hodgkin (Dozimi: e)
  leuçemia limfocitike kronike (Dozimi: e)
  makroglobulinemia Waldenstrom (Dozimi: e)
  mieloma e shumëfishtë (Dozimi: e)
  nivelet e larta të kalçiumit në gjak si pasojë e një sëmundjeje malinje ekzistuese (Dozimi: c deri në a)
- parandalimi dhe trajtimi i të vjellave si pasojë e kemioterapisë (Dozimi: b deri në a).

Shënim:
Cutason mund të përdoret në fazat e avancuara të sëmundjeve malinje për lehtësimin e simptomave si: humbja e oreksit, humbja e peshës dhe dobësia e përgjithshme, pasi trajtime të tjera alternative nuk kanë patur sukses.

Sëmundje të sistemit nervor:
- disa forma të paralizës (myasthenia gravis), zgjedhja e parë është azatioprina
- sindroma kronike Guillan-Barré
- sindroma Tolosa-Hunt
- polineuropatia si pasojë e gamopatisë monoklonale
- skleroza e shumëfishtë (për zvogëlimin gradual të dozës pasi janë kryer perfuzione me doza të larta glukokortikoidësh për trajtimin e një ataku akut)
- disa forma epileptike tek foshnjet (krampet BNS)

Forma progresive specifike të sëmundjeve infektive:
- situata helmimesh në sëmundje të rënda infektive (në kombinim me antibiotikë / kemioterapi), si p.sh. meningiti tuberkular (Dozimi: b), forma të rënda të tuberkulozit pulmonar (Dozimi: b)

Sëmundje të syve (Dozimi: b deri në a)
- sëmundje dhe proçese inflamatore që prekin syrin dhe orbitën e syrit: sëmundjet që prekin nervin optik (neuropati optike, si p.sh. arteriti me qeliza gjigante që vjen si pasojë e problemeve të qarkullimit të gjakut ose dëmtimeve), sindroma Behçet, sarkoidoza, orbitopatia endokrine, enjtja e dukshme e orbitës, reaksioni i flakjes së transplantit dhe disa sëmundje të koroidit si sëmundja Harada dhe oftalmia simpatike.

Në sëmundjet e mëposhtme, Cutason mund të jepet vetëm atëhere kur trajtimi lokal nuk ka qenë i efektshëm:
- inflamacioni i pjesëve të ndryshme të syrit:
  inflamacioni i dermës dhe indeve përreth, i kornesë ose i koroidit, inflamacioni kronik i dhomës përgjegjëse për formimin e ujit në sy, konjunktiviti alergjik, djegjet nga substanca alkaline, inflamacioni i kornesë që vjen si pasojë e një sëmundjeje autoimune ose sifilizit (në këtë rast është i nevojshëm një trajtim shtesë kundër patogjenit), inflamacioni i kornesë i shkaktuar nga Herpes simplex (vetëm në rastet kur sipërfaqja e kornesë nuk është e dëmtuar dhe nën kontroll oftalmologjik rigoroz).

Çrregullime gastrointestinale / sëmundje të mëlçisë:
- kolit ulçeroz (Dozimi: b deri në c)
- sëmundje e Krohnit (Dozimi: b)
- sëmundje autoimune të mëlçisë (hepatiti autoimun) (Dozimi: b)
- korrozion i ezofagut (Dozimi: a)

Sëmundje të veshkave:
- sëmundje autoimune të veshkave: sëmundja Nil (glomerulonefriti me ndryshime të vogla) (Dozimi: a), glomerulonefriti ekstrakapilar proliferativ (glomerulonefriti me zhvillim të shpejtë) (Dozimi: doza sulmi zakonisht në kombinim me barna citostatikë), për zvogëlimin e dozës dhe përfundimin e trajtimit në sindromën Goodpasture, për vazhdimin e trajtimit afatgjatë të të gjitha formave të tjera (Dozimi: d)
- përhapje të indit lidhor në zonën midis veshkave dhe legenit pa një shkak të përcaktuar (fibroza retroperitoneale) (Dozimi: b).

2. PËRPARA SE TË MERRNI CUTASON

Mos merrni Cutason nëse:
- keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj prednizonit apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Cutason.

Për trajtimin afatshkurtër me Cutason të sëmundjeve që mund të vënë jetën në rrezik, nuk ka kundërindikacione të mëtejshme (përveç reaksioneve të mbindjeshmërisë të sipërpërmendura).

Tregoni kujdes të veçantë me Cutason
- nëse nevojiten doza më të larta sesa ato të përdorura në terapinë e zëvëndësimit të hormoneve.

Në sëmundjet e mëposhtme, Cutason duhet përdorur vetëm nëse mjeku juaj e sheh të domosdoshme. Njëkohësisht, nëse është e nevojshme, duhet marrë një trajtim shtesë që lufton mikroorganizmin patogjen specifik.

- infeksione virale akute (lija e dhenve, infeksionet nga herpes zoster, infeksionet nga herpes simplex, inflamacioni i kornesë i shkaktuar nga virusi i herpesit)
- infeksione bakteriale akute dhe kronike
- infeksione mykotike (nga kërpudhat) që prekin organet e brendshme
- disa sëmundje të shkaktuara nga parazitët (ameba, infeksionet nga krimbat)
- sëmundjet e nyjeve limfatike që vijnë si pasojë e vaksinës ndaj tuberkulozit (në rast se pacienti ka vuajtur nga tuberkulozi, njëkohësisht duhet marrë një trajtim me antituberkularë)
- hepatiti infektiv (hepatiti kronik aktiv HbsAg-pozitiv)
- poliomieliti
- 8 javë para dhe 2 javë pas vaksinimit me një vaksinë që përmban mikroorganizma të gjallë.

Gjithashtu, Cutason mund të përdoret në sëmundjet e mëposhtme, vetëm nëse mjeku juaj e sheh të nevojshme dhe nëse këto sëmundje trajtohen njëkohësisht me terapinë shtesë të nevojshme.

- ulçerat gastrointestinale
- hipertensioni vështirësisht i trajtueshëm
- diabeti i rëndë (diabeti melitus)
- çrregullimet e kockave (osteoporoza)
- sëmundjet mendore aktuale ose të mëparshme
- rritja e presionit intraokular (glaukoma me kënd të ngushtë ose të gjerë)
- ulçerat ose dëmtimet e kornesë së syrit.

Duke qenë se ekziston rreziku për çarje të murit të zorrëve (gjë që mund të çojë në peritonit), Cutason mund të përdoret në sëmundjet e mëposhtme vetëm nëse ka arsye të forta mjekësore dhe nën kontroll të vazhdueshëm.
- inflamacioni i rëndë i kolonit (koliti ulçeroz) i shoqëruar me perforacion, absces ose qelbëzim
- divertikuliti (masë e inflamuar në murin e zorrëve)
- pas disa ndërhyrjeve kirurgjikale (enteroanastomozat), menjëherë pas ndërhyrjes.

Në fillim të trajtimit me Cutason për miastenia gravis mund të shfaqet përkeqësim i gjendjes. Në këtë rast, përshtatja e dozës duhet kryer pranë strukturave spitalore. Duhet patur veçanërisht kujdes gjatë fillimit të trajtimit me Cutason nëse pacienti paraqet probleme të rënda në zonën e fytyrës, fytit dhe insufiçiencë në frymëmarrje.
Trajtimi me Cutason mund të maskojë shenjat e një infeksioni, duke vështirësuar kështu identifikimin e tij.
Trajtimi afatgjatë me prednizon edhe pse me doza të vogla, mund të rrisë rrezikun për një infeksion, përfshirë këtu organizma patogjenë që në kushte të tjera rrallë do ta shkaktonin atë.
Vaksinimi me organizma patogjenë jo të gjallë është i mundur. Megjithatë, duhet theksuar se, doza të larta të Cutason mund të ndikojnë në përgjigjen e pacientit ndaj vaksinës.
Gjatë trajtimit afatgjatë me Cutason, pacienti duhet të kryejë kontrolle të rregullta mjekësore (përfshirë ato okulistike).
Në pacientët diabetikë mund të jetë e nevojshme rritja e dozës së barnave antidiabetikë (insulina, tabletat e marra nga goja etj.). Këta pacientë duhet të kryejnë kontrolle të rregullta mjekësore për të mbajtur metabolizmin nën kontroll.
Gjatë trajtimit afatgjatë me doza relativisht të larta të Cutason duhet treguar kujdes që të merret një sasi e mjaftueshme kaliumi (si p.sh. nga zarzavatet, bananet etj.) dhe të kufizohet sasia e kripës. Nivelet e kaliumit në organizëm duhen mbajtur nën kontroll nga mjeku.
Nëse vuani nga hipertensioni i rëndë ose insufiçienca e rëndë kardiake, duhet të kryeni kontrolle të vazhdueshme tek mjeku, pasi mund të ketë përkeqësim të gjendjes.
Nëse gjatë trajtimit me Cutason kaloni një sëmundje që shoqërohet me temperaturë, pësoni një aksident apo i nënshtroheni një ndërhyrjeje kirurgjikale, ju duhet të informoni menjëherë mjekun ose qendrën ambulatore për trajtimin në fjalë. Mund të jetë e nevojshme një rritje e përkohshme e dozës ditore të Cutason.
Nëse trajtimi me Cutason zgjat për një periudhë afatgjatë, mjeku duhet t'ju pajisë me një kartë specifike, të cilën duhet ta mbani gjithmonë me vete.
Duke qenë se në varësi të dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit mund të ndodhin çrregullime në metabolizmin e kalciumit, duhen marrë masa për parandalimin e osteoporozës. Kjo mund të ndodhë veçanërisht në pacientët që kanë disa faktorë rreziku si: trashëgimia familjare, mosha e madhe, marrja e pamjaftueshme e kalçiumit dhe proteinave, pirja e duhanit, konsumi i tepërt i alkoolit, periudha pas menopauzës dhe mungesa e aktivitetit fizik. Për të parandaluar këto çrregullime duhet marrë një sasi e mjaftueshme kalçiumi, vitamine D dhe të kryhet aktivitet fizik. Në rastet e një osteoporoze ekzistente duhet marrë gjithashtu një terapi shtesë e përshtatshme.
Pas ndërprerjes ose përfundimit të trajtimit afatgjatë me Cutason duhet të merren në konsideratë rreziqet e mëposhtme:
rikthim ose përkeqësim i sëmundjes ekzistuese, insufiçiencë akute e gjendrës mbiveshkore (veçanërisht në situata ku organizmi është në gjendje stresi si p.sh. gjatë një infeksioni, pas një aksidenti, stresi fizik të rritur), shenja dhe simptoma që vijnë nga ndërprerja e trajtimit me kortizonikë. Në pacientët që trajtohen me Cutason mund të shfaqen sëmundje virale të rënda. Veçanërisht të rrezikuar janë fëmijët me çrregullime të sistemit imunitar (dobësim të sistemit imunitar) ose personat që nuk kanë kaluar fruthin ose linë e dhenve. Nëse këta persona, gjatë trajtimit me Cutason, bien në kontakt me persona që po kalojnë sëmundjet e sipërpërmendura, duhet të kontaktojnë menjëherë mjekun. Në këto raste mund të jetë e nevojshme të ndërmerret një terapi parandaluese.

Pasojat mbi testet laboratorike
Mund të ulet përgjigjja e lëkurës ndaj testeve alergjike.

Fëmijët
Duke qenë se trajtimi me Cutason mund të frenojë rritjen tek fëmijët, ky bar duhet përdorur vetëm nëse mjeku e sheh të nevojshme dhe rritja e fëmijës duhet monitoruar vazhdimisht.

Pasojat e keqpërdorimit për qëllime dopingu
Trajtimi me Cutason mund të japë një përgjigjje pozitive në testet për doping. Megjithëse nuk mund të parashikohen pasojat për shëndetin e personave që përdorin Cutason për qëllime dopingu, nuk mund të përjashtohen pasojat e rënda.

Marrja e Cutason me barna të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë/përdorur apo keni marrë/përdorur së fundmi barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetën e mjekut.

Cilat janë barnat që mund të ndikojnë në efikasitetin e Cutason?
- barnat që nxisin metabolizimin nga mëlçia (barbituratet, fenitoina, primidoni [për trajtimin e konvulsioneve], rifampicina [për trajtimin e tuberkulozit]):
  efikasiteti i Cutason mund të zvogëlohet.
- disa hormone seksuale femërore, si p.sh. kontraceptivët:
  efikasiteti i Cutason mund të rritet.
- barna që veprojnë kundër prodhimit të tepërt të aciditetit në stomak (antiacide): në pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike të mëlçisë mund të jetë e nevojshme rritja e dozës.

Si ndikon Cutason në veprimin e barnave të tjerë?

Marrja në të njëjtën kohë e Cutason me
- barna që veprojnë në tonusin kardiak (glikozide kardiake):
  duke qenë se Cutason mund të shkaktojë mungesë të kaliumit në organizëm, efekti i këtyre barnave mund të rritet
- barna diuretikë dhe laksativë:
  rritet efekti i tyre mbi jashtëqitjen e kaliumit
- barna që trajtojnë diabetin (antidiabetikë/insulina):
  mund të zvogëlohet efekti hipoglicemik
- antikoagulantë (antikoagulantë oralë, derivatet e kumarinave):
  efekti i tyre mund të zvogëlohet
- barna kundër inflamacionit dhe reumatizmës (salicilatet, indometacina dhe barna të tjerë anti-inflamatorë josteroidë):
  mund të rritet rreziku për ulçer dhe hemorragji gastrointestinale
- disa barna që shkaktojnë lëshim të muskujve (relaksantë muskularë jo-depolarizues):
  koha e relaksimit të muskujve mund të zgjatet
- disa barna oftalmologjikë (atropina) dhe barna që veprojnë në mënyrë të ngjashme (antikolinergjikë të tjerë):
  mund të ndodhë rritje e mëtejshme e presionit intraokular
- barna për trajtimin e sëmundjeve të shkaktuara nga krimbat (prazikuanteli):
  mund të zvogëlohet efikasiteti i këtij bari
- barna për trajtimin e malaries dhe sëmundjeve reumatike (klorokina, hidroklorokina, meflokina):
  mund të rritet rreziku për miopati dhe kardiomiopati
- hormoni i rritjes (somatropina):
  veçanërisht doza të mëdha të Cutason mund të zvogëlojnë efikasitetin e këtij bari
- protirelina (një hormon i trurit të mesëm):
  frenohet rritja e hormonit stimulues të tiroides (TSH)
- ciklosporina (përdoret për të frenuar sistemin imunitar të organizmit):
  rriten nivelet e ciklosporinës në gjak; kjo mund të çojë në rritje të rrezikut për konvulsione
- disa barna që përdoren për të ulur presionin e gjakut (ACE inhibitorë):
  rritet rreziku për diskrazi të gjakut

Shtatzënia dhe ushqimi me gji

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni/përdorni çdo bar.

Shtatzënia
Gjatë periudhës së shtatzënisë, ky bar mund të merret vetëm me përshkrimin e mjekut. Informoni mjekun tuaj nëse jeni shtatzënë.
Gjatë trajtimit afatgjatë me Cutason në periudhën e shtatzënisë nuk mund të përjashtohen edhe çrregullime në rritjen e fetusit.
Nëse Cutason merret në periudhën e fundit të shtatzënisë mund të shfaqet insufiçiencë e gjendrës mbiveshkore tek i porsalinduri.

Ushqimi me gji
Prednizoni kalon në qumështin e gjirit. Deri tani nuk njihen raste të dëmtimit të fetusit. Megjithatë, nevoja për administrimin e Cutason gjatë ushqimit me gji, duhet shqyrtuar me kujdes. Nëse nevojiten doza të larta të Cutason ju nuk duhet të ushqeni fëmijën me gji.

Efektet mbi drejtimin e automjetit dhe përdorimin e makinerive
Deri tani, nuk ka asnjë dëshmi se Cutason ndikon në aftësinë për drejtimin e automjetit apo përdorimin e makinerive. Kjo vlen edhe për personat që punojnë pa një mbështetje sigurie.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Cutason
Ky bar përmban laktozë. Nëse keni një intolerancë të njohur ndaj disa lloje sheqernash pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Cutason.

3. SI TA MERRNI CUTASON

1. Gjithmonë merreni Cutason ashtu siç ju ka thënë mjeku juaj.
2. Doza individuale përcaktohet nga mjeku juaj.
3. Ju lutemi, ndiqni përshkrimin e recetës, përndryshe Cutason mund të mos veprojë siç duhet.
4. Nëse nuk jeni i sigurt, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është:
Si terapi e zëvëndësimit të hormoneve (pasi ka kaluar mosha e rritjes)

5 deri në 7.5 mg prednizon / ditë, e dhënë në dy doza të ndara (në mëngjes dhe në mesditë, në hiperplazinë kongjenitale të gjendrës mbiveshkore në mëngjes dhe në darkë); nëse është e nevojshme, si mjekim plotësues mund të merret dhe një mineralkortikoid (fludrokortizon). Në situata të veçanta stresi fizik si infeksionet e shoqëruara me temperaturë, plagët, ndërhyrjet kirurgjikale ose lindjet, doza duhet të rritet në mënyrë të përkohshme, ashtu siç ju këshillon mjeku juaj.
Gjendje stresi si pasojë e përdorimit afatgjatë të glukokortikoidëve: fillimisht deri në 50 mg prednizon / ditë.
Zvogëlimi i dozës bëhet përgjatë disa ditëve.

Trajtimi i disa sëmundjeve të caktuara (farmakoterapi)

Tabelat e mëposhtme paraqesin një pasqyrë orientuese të dozimit:

1. Të rriturit

Dozimi	Doza në mg / ditë	Doza në mg / kg peshë / ditë
Dozimi a) I lartë	80 - 100 (250)	1,0 - 3,0
Dozimi b) Mesatar	40 - 80	0,5 - 1,0
Dozimi c) I ulët	10 - 40	0,25 - 0,5
Dozimi d) Shumë i ulët	1,5 - 7,5 (10)	./.

Dozimi e) për çrregullimet e gjakut nëpërmjet skemave të veçanta, shih më poshtë.
Në përgjithësi, doza e plotë ditore merret në mëngjes midis orës 06:00 dhe 08:00.
Në varësi të sëmundjes, dozat e larta ditore, mund të ndahen në 2-4 doza ditore mesatare që merren 2-3 herë në ditë.

2. Fëmijët

Dozimi	Doza në mg / kg peshë / ditë
E lartë	2 - 3
Mesatare	1 - 2
Doza mbajtëse	0,25

Fëmijët duhet të marrin dozën më të vogël të mundshme.
Mund të përjashtohen nga ky rekomandim raste të veçanta (si p.sh. krampet BNS).

Pasi arrihet efekti i dëshiruar, në varësi të sëmundjes, duhet filluar zvogëlimi i dozës. Pasi doza ditore e plotë ndahet në disa doza, zvogëlohet fillimisht doza e marrë në darkë e më pas doza e marrë në mesditë. Pas kësaj periudhe, doza zvogëlohet me hapa disi më të mëdha, për doza më të vogla se 25 mg / ditë zvogëlimi bëhet më gradualisht. Kohëzgjatja e trajtimit është në varësi të rrjedhës së sëmundjes. Pasi arrihet efekti i dëshiruar, doza mund të zvogëlohet deri në një dozë mbajtëse ose trajtimi ndërpritet. Mjeku juaj përcakton skemën e dozimit, të cilën ju duhet ta ndiqni në mënyrë rigoroze.
Doza të larta dhe shumë të larta, që mund të jepen për disa ditë, në varësi të sëmundjes ekzistuese dhe suksesit të trajtimit, mund të zvogëlohen në mënyrë të menjëhershme.
Edhe në hipotiroidizëm dhe cirrozë të mëlçisë, mund të nevojitet një dozë më e vogël ose një zvogëlim i dozës.

Dozimi e)
Zakonisht, prednizoni jepet si një dozë e vetme, pa qenë nevoja për ndyshime graduale afër fundit të trajtimit. P.sh. në kemioterapi janë të mirënjohura skemat e mëposhtme të trajtimit:
- limfoma jo-Hodgkin: skema CHOP, prednizon 100 mg / m2 ditë 1-5, skema COP, prednizon 100 mg / m2 ditë 1-5
- leuçemia limfoblastike akute: skema bud, prednizon 75 / 50 / 25 mg ditë 1-3
- sëmundja Hodgkin: skema COPP-ABVD, prednizon 40 mg / m2 ditë 1-14
- mieloma e shumëfishtë: skema Alexanian, prednizon 2 mg / kg peshë ditë 1-14

Mënyra e administrimit
Gëlltitini tabletat të plota me një sasi të madhe lëngjesh, gjatë ose menjëherë pas ushqimit. Mjeku juaj, në varësi të sëmundjes dhe përgjigjes individuale ndaj mjekimit, do të vendosë mbi mundësinë e marrjes së dozës vetëm një herë çdo dy ditë.

Kohëzgjatja e trajtimit
Terapia e zëvendësimit të hormoneve në insufiçiencën kronike të gjendrës mbiveshkore është afatgjatë. Nëse ndjeni se efektet e Cutason janë shumë të forta ose shumë të dobëta, ju lutemi kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni marrë më shumë Cutason
Përgjithësisht Cutason tolerohet mirë, pa ndërlikime edhe në rastet kur merren doza të larta për një periudhë të shkurtër. Nuk është e nevojshme të ndërmerren masa të veçanta. Nëse vëreni efekte anësore të shtuara apo të pazakonta, këshillohuni me mjekun tuaj.

Në qoftë se keni harruar të merrni Cutason
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Mund të kompensoni dozën e humbur gjatë ditës dhe në ditët në vazhdim merri dozën ashtu siç jua ka përshkruar mjeku juaj.
Nëse harroni të merrni një dozë disa herë, mund të ketë rikthim apo përkeqësim të sëmundjes për të cilën jeni duke u trajtuar. Në këto raste, këshillohuni me mjekun tuaj, i cili do të vlerësojë situatën dhe do vendosë nëse është e nevojshme një përshtatje e dozimit.

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Cutason
Gjithmonë ndiqni skemën e dozimit që ju ka përshkruar mjeku juaj. Cutason nuk duhet të jepet asnjëherë pa recetën e mjekut, veçanërisht për arsye se trajtimi afatgjatë me Cutason mund të çojë në ulje të prodhimit të glukokortikoidëve nga organizmi.

Një gjendje e rëndë stresi fizik mund të jetë e rrezikshme për jetën (kriza Adisoniane).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Cutason mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Si terapi e zëvendësimit hormonal
Nëse ndiqen dozat e rekomanduara, rreziku për efekte anësore është i ulët.

Trajtimi i disa sëmundjeve, përdorimi i dozave më të larta sesa ato të përdorura në terapinë e zëvendësimit hormonal
Në varësi të dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit mund të shfaqen efektet anësore të mëposhtme:

Çrregullime endokrine
E ashtuquajtura sindroma Cushing (shenja tipike si facies lunata, obezitet abdominal, afshe të nxehta), insufiçiencë ose atrofi e korteksit të gjendrës mbiveshkore, frenim i rritjes tek fëmijët, çrregullim i hormoneve seksuale (çrregullime menstruale, impotencë).

Çrregullime të metabolizmit dhe të të ushqyerit
Mundësi depozitimi të përkohshëm të dhjamit në pjesë të ndryshme të trupit, si p.sh. në kanalin spinal (epidural) ose në kraharor (epikardiak, mediastinal). Rritje në peshë, nivel i lartë i sheqerit në gjak, diabet, rritje e nivelit të yndyrnave në gjak (kolesterol dhe trigliceride) dhe lëngjeve në inde, mungesë kaliumi si pasojë e rritjes së jashtëqitjes së tij.

Çrregullime të lëkurës dhe indit subkutan
Shenja tërheqjeje të lëkurës (strije), hollim i lëkurës, shtim i enëve të gjakut në lëkurë, mavijosje, shtim i qimeve në trup, akne, vonesë në shërimin e plagëve, dëmtime të inflamuara në lëkurë veçanërisht afër gojës, hundës dhe syve, ndryshime në ngjyrën e lëkurës, reaksione mbindjeshmërie, si p.sh. rash.

Çrregullime muskulo-skeletike dhe të indit lidhor
Dobësi e muskujve ose humbje e masës muskulare dhe humbje e masës kockore (osteoporozë) që janë në varësi të dozës dhe mund të shfaqen edhe pas përdorimit afatshkurtër, forma të tjera të humbjes së masës kockore (nekrozë e kockave si ajo e kokës së humerusit dhe femurit)

Shënim: Zvogëlimi shumë i shpejtë i dozës pas përdorimit afatgjatë mund të shkaktojë dhimbje të muskujve dhe kyçeve.

Çrregulllime psikiatrike / çrregullime të sistemit nervor
Depresion, irritim, eufori, rritje e oreksit, psikoza, pagjumësi, rritje e presionit intrakranial (veçanërisht tek fëmijët), shfaqje e epilepsisë tek persona që nuk kanë vuajtur më parë dhe rritje e tendencës për konvulsione tek personat epileptikë.

Çrregullime gastrointestinale
Ulçer gastrointestinale, hemorragji gastrointestinale, pankreatit.

Çrregullime të sistemit vaskular
Hipertension, rritje e rrezikut që aterosklerozë dhe trombozë, vaskulit (e njohur gjithashtu si sindroma e ndërprerjes së trajtimit afatgjatë).

Çrregullime të gjakut dhe sistemit limfatik / çrregullime të sistemit imunitar
Çrregullime të gjakut (rritje e numrit të rruazave të bardha ose të të gjitha qelizave të gjakut, zvogëlim i numrit të disa llojeve të caktuara të rruazave të bardha), dobësim i sistemit imunitar (si p.sh. rritje e rrezikut për infeksione, aktivizim i infeksioneve të fshehura, maskim i infeksioneve), reaksione alergjike. reaksione alergjike.

Çrregullime të syve
Rritje e presionit intraokular (glaukomë), katarakt, përkeqësim i ulçerave korneale duke favorizuar kështu inflamacionet e shkaktuara nga viruset, bakteret apo kërpudhat, rritje e rrezikut për korioretinopati seroze qendrore (sëmundje që prek retinën dhe shoqërohet me humbje të shikimit). Ju duhet të kryeni konsulta të rregullta tek mjeku okulist.

Masat që duhet të ndërmerren
Ju lutemi njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse gjatë trajtimit me Cutason ju shfaqen këto efekte anësore ose ndonjë efekt anësor tjetër që nuk përmendet më sipër.
Mos e ndërprisni trajtimin pa u këshilluar me mjekun tuaj.
Nëse keni shqetësime gastrointestinale, dhimbje mesi, shpatulle ose të ijeve, probleme mendore, luhatje të theksuara të nivelit të sheqerit në gjak (tek diabetikët) ose shqetësime të tjera, informoni menjëherë mjekun tuaj.
Ju lutemi njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse ndonjë prej efekteve anësore bëhet serioz, ose vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues.

5. SI TA RUANI CUTASON

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni pas datës së skadencës të shënuar mbi blister dhe kutinë e kartonit.

Kushtet e ruajtjes
Nuk është e nevojshme që ky bar të ruhet në kushte të veçanta.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Cutason

Lënda vepruese është Prednizon, një hormon i gjendrës mbiveshkore.

1 tabletë përmban 5 mg prednizon.
½ tablete përmban 2.5 mg prednizon.

Përbërësit e tjerë janë: laktozë monohidrat, celulozë pluhur, glikol